



Republika e Kosovës

Komuna Rahovec/Opština Orahovac

Municipality Rahovec

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E RAHOVECI - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odrejenje za Opštu Upravu
Nr. l prot 511 Më 14.02.23
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

Mbështetur në Ligjin për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092 e datës 07.03.2019, në Rregulloren QRK Nr.09/2020 të datës 10.08.2020 për cakimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, neni 34, pika 5 të rregullores komunale për taksa komunale, 01/80 të datës: 29.06.2020, si dhe vendimeve të Kuvendit Komunal të Rahovecit, 01Nr.189/21 të datës 29.04.2021. Komisioni Vlerësues i ofertave për dhënie e pronës së paluajtshme në shfrytëzim i caktuar me vendim të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, 01Nr.08/23, të dt. 30.01.2023, shpallë këtë:

NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK

PËR DHËNIE E PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATSHKRTËR

Njoftim publik për dhënie e pronave të paluajtshme në pronësi të Komunës, përmban si në vijim:

- Parcela Kadastrale nr. P-71510057-05864-0, ne sipërfaqe te përgjithshme 2031 m2 PSN e Kosovës KK Rahovec, me kulturë arë e klasës 5, qe gjendet ne vendin e quajtur "Przhina" ZK Rahovec.

Afati i dhënies në shfrytëzim:

Afati i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës është afatshkurtër prej dhjetë (10) vitesh.

Veprimtaria që ushtrohet sipas destinimit të pronës:

Shfrytëzimi i pronës së marrë në shfrytëzim mund të shërbej vetëm për qëllime bujqësore.

Gmimi fillestar i pronës që është objekt i dhënies në shfrytëzim përmes ankandit.

Gmimi fillestar për dhënie e pronës në shfrytëzim të tokës bujqësore është i përcaktuar sipas Nenit 34, pika 5.2 të rregullores komunale për taksa komunale, 01/80 të datës 29.06.2020 për dhënie në shfrytëzim të tokë bujqësore.

Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik dhe data e fundit e dorëzimit të ofertave:

Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik per dhënie e pronave për shfrytëzim afatshkurtër është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në ueb-faqen e Komunës, në vendet publike, elektronike dhe të shkruara.

Dokumentacioni për ofertim tërhiqet në zyrën e prokurimit në Rahovec nga data: **14.02.2023, deri me datë: 28.02.2023** në ora: **15:00 h.**

Aplikimi bëhet në zyrën e Prokurimit, çdo ditë pune (**08:00)h deri (16:00).**

Vendi, koha ku do të mbahet ankand publik:

Në sallën e Kuvendit Komunal, me datën 02.03.2023 në fillim në ora: **14:00**, do të bëhet hapja e ofertave të mbyllura dhe të njëjtat do të bëhen publike gjatë hapjes, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në ankand publik.

Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në ankand publik;

Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik,

- Personat fizik krahas aplikacionit në kuvertë duhet të ofrojnë edhe kopjen e letërnjoftimit dhe dëshminë mbi pagesën e tatimit në pronë për gjashtëmujorit të dytë të vitit 2022.
- Personat juridik, krahas aplikacionit në kuvertë duhet ta bashkëngjisin
 - I. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me informata mbi biznesin.
 - II. Vërtetimin e taksës komunale në afarizëm,
 - III. Vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës,
 - IV. Vërtetimin e tatimit në pronë për periudhën e gjashtëmujorit të dytë të vitit 2022.

Pjesëmarrësve në konkurrim iu garantohet e drejta që të:

- Informohen lidhur me procedurat e ankandit publik,
- Shohin pronën që do të jepet në shfrytëzim,
- Kanë qasje në dokumentacionet e pronës,
- Tërhiqen nga ankand i jo më vonë se tre (3) ditë para mbajtjes së ankandit publik.
- Fituesi duhet të nënshkruaj regjistrin e procedurës së ankandit publik. Nëse informatat e dhëna nga ofertuesi dëshmojnë si të pasakta, komisioni ka të drejtën që të refuzojë dhënien e pronës në shfrytëzim.

Raporti i vlerësimit të ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës;

- Komisioni vlerësohet brenda tri (3) ditë pune nga përfundimi i vlerësimit të ofertave në ankand publik, harton raportin përfundimtar për përmbijljen e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtyr të pronës së paluajtshme të Komunës.
- Raporti përfundimtar i Komisionit vlerësohet të ofertave të ankandit publik përmban:
 - Një kopje të shpalljes së ankandit publik;
 - Procesverbalin e procesit të ankandit publik;
 - Rekomandimin e Komisionit për zgjedhjen e fituesit;
 - Një kopje të protokollit të ofrtes së përzgjedhur,
- Ankesat e parashtruara nga pjesëmarrësit në ankand publik.
- Pas miratimit të ofrtes së përzgjedhur nga Komisioni vlerësohet, njoftimi i dërgohet fituesit dhe i

- njëjti publikohet në tabelën e shpalljeve dhe në ueb - faqen e Komunës. Ofertuesi me çmimin më të lartë të ofruar në pliko të mbyllura do të shpallet fitues gjatë procesit të hapjes së ofertave.
- Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë komisionit për vlerësimin e ankesave në afat prej shtatë (7) ditësh.
 - Nëse komisioni i ankesave konstaton se ka shkelje gjatë procesit të vlerësimit ka të drejtë të kërkojë rishqyrtimin e procesit, por nëse komisioni i ankesave vlerëson se nuk ka bazë, atëherë ankesën e refuzon si të pabazuar.
 - Kontrata për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe fituesi i zgjedhur, brenda 15 ditësh pune nga data e miratimit të ofertës nga ana e komisionit vlerësues.

Vërejtje:

Tërheqja e aplikacioneve për konkurrim në ankand publik bëhet në formë fizike në zyrën e prokurimit në Rahovec.

Rahovec: 14.02.2023

Komisioni vlerësues i Ofertave